



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Mr. Laura Kryeziu

Kryetare e Këshillit Drejtues të UP-së

Nr. Prot.: 846

Date: 28/3/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të Kërkesës nr. 5/352, të datës: 26 dhjetor 2018, të parashtruar nga prof. dr. Hivzi Muharremi, ish mësimdhënës në Fakultetin e Artit të Universitetit të Prishtinës, për kompensim të pagave pas pensionit. Në mbledhjen e mbajtur me 07.03 2019, merr këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa me nr. prot: 5/352, të datës: 26 dhjetor 2018, për kompensim të pagave pas pensionimit të parashtruar nga prof. dr. Hivzi Muharremi, ish mësimdhënës në Fakultetin e Artit të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina"
- II. Kërkesa me nr. ref: nr. prot: 5/352, të datës: 26 dhjetor 2018 është e pasafatshme, pasi që prof. dr. Hivzi Muharremi, ka arrit moshën e pensionimit me UP-në, me datë 16.02.2013.
- III. Vlen vendimi mbi pensionimin ku i përmenduri është pensionuar sipas vendimin me nr. prot. 733 të datës: 29 mars 2013, dhe çdo kërkesë tjetër është e pasafatshme, pasi që ndaj vendimi të lartcekur ka pasur të drejtën e shfrytëzimit të këshillës juridike në afat prej 8 ditësh.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2019, pasi shqyrtoi kërkesën nr. 5/352, të datës: 26 dhjetor 2018, të parashtruar nga prof. dr. Hivzi Muharremi, ish mësimdhënës në Fakultetin e Artit të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" për kompensimin e tri pagave si shpërblime jubilarë dhe tri pagave pas pensionimit, ku i përmenduri ka arrite moshën e pensionimit më 29 mars 2013, të cilit në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 03/13 dt: 27.03.2008, ju është vazhduar kontrata deri në përfundim të vitit akademik gjegjësisht deri më 30 shtator 2013. KD-konsideroi se kontrata kolektive nuk ka karakter obligativ dhe atë duke u mbështetur në praktikën e institucioneve të tjera shtetërore të cilat nuk e kanë zbatuar asnjë herë kontratën kolektive të punës, sepse një kontratë e tillë e nënshkruar në mes partnerëve social ka kërkuar edhe ndarjen e kostos së lartë buxhetore. të cilën qeveria e Kosovës nuk e ka paraparë për asnjë institucion.

Prof. dr. Hivzi Muharremi, ish mësimdhënës në Fakultetin e Artit të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" në bazë të vendimit të UP-së me nr. prot: 733 të datës: 29 mars 2013, është njoftuar për moshën e pensionimit. Në atë vendim nuk është përcaktuar se a do t'i takoj e drejta e kompensimit pas pensionimit sipas kontratës së përgjithshëm Kolektive, sepse Kontrata Kolektive nuk ka gjetur zbatim tek as një institucion publik e po ashtu Qeveria e Rep. Kosovës nuk ka paraparë as vazhdimin e saj pas vitit 2008.

Kontrata e Përgjithshme Kolektive është nënshkruar me 20.09.2004 dhe është plotësuar me Aneks Kontratë i cili është nënshkruar me 01.07.2005 nga Partnerët Social (Qeveria e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës). Kontrata e Përgjithshme Kolektive është nxjerr në mbështetje të nenit 6 të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut Reg.2001/XX të dt. 8 tetor 2001 , Rregullores nr. 2001/36 mbi shërbimin Civil të Kosovës, nenit 2, paragrafi (b) i Udhëzimit nr. 2001/17 mbi strukturën dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ trepalësh.

Pas nënshkrimit të Kontrata e Përgjithshme Kolektive, meqenëse nuk kishte filluar zbatimimi i kësaj kontrate me dt.01.07.2005 është nënshkruar edhe aneksi i Kontratës se Përgjithshme Kolektive nga partnere Social të cilët janë pajtuar se implementimi i kësaj kontrate te filloj nga dt. 01.07.2005 deri më 01.07.2008.


Për kundër të këtyre aktiviteteve kjo kontrate fatkeqësisht nuk ka mund të implementohet në tërësi në institucionet e shtetit për shkak të kostos se larte financiar dhe pikërisht për këtë arsye Universiteti i Prishtinës nuk ka pasur mundësi financiare dhe një buxhet të planifikuar për kompensim të tillë ashtu siç nuk ka planifikuar buxhet për këtë destinim asnjë prej institucioneve tjera shtetërore.

Për shkak të karakterit që kanë kontratat kolektive lidhen për kohë të caktuar dhe atë më së shumti për periudhën deri në tri vjet. Prandaj afati i Marrëveshjes Kolektive ka skaduar për implementim, palët të cilat e kanë lidhë kontratën mund që me marrëveshje ta zgjasin afatin e vlefshmërisë së kontratës ose që të lidhin kontratë të re.

Për shkak të karakterit që kanë kontratat kolektive lidhen për kohë të caktuar dhe atë më së shumti për periudhën deri në tri vjet. Prandaj në periudhën kur pala ka dal në pension nuk ka qenë në fuqi as një kontratë kolektive, si dhe i njëjti ka bërë kërkesë për kompensim pas gjashtë (6) viteve pas pensionimit. Mbi këtë bazë dhe nga ajo që u tha më lartë KD- ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendim t'u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së,
2. Parashtruesit të Kërkesës,
3. Shërbimit financiar të F. Artit;
4. Zyrës Ligjore të UP,
5. Asistentes së KD-së,
6. Uebfaqe të UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Lajla Kryeziu - Kryesuese